



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 769 prot.

Tiranë, më 29.09.2020

VENDIM
Nr.98, datë 29.09.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 42, DATË 26. 04. 2019

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 42, datë 26. 04. 2019, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 96, datë 03.12.2018, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimi e shërbimit civil, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër dhe Fushë - Krujë”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në institucionin Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin Paralajmërues Nr. 42, datë 26. 04. 2019, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër me shkresën nr. 39 prot., datë 01.06.2020, *“Informacion”*, ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të

detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues dhe në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim. Konkretisht:

1. Sipas akteve të administruara në dosjen e verifikimit rezulton se, formularët e përshkrimit të punës kanë marrë miratimin e DAP, dhe një kopje tashmë është pjesë e dosjes personale të nëpunësit.
2. Njësia përgjegjëse ka marrë të gjitha masat duke plotësuar mangësitë e konstatuara në dosjet individuale të personelit (*gjendja shëndetësore, gjendja gjyqësore*) për secilin nëpunës dhe duke i bërë pjesë të këtyre dosjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 42, datë 26. 04. 2019, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Shkodër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Shkodër, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 42, datë 26.04.2019.
3. Për këtë vendim të njoftohet Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Shkodër, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Departamenti i Administratës Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha